

Vendim nr. 137 datë 24.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 24.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (D) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: DENIS SHTRAZA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 31, datë 19.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 61, datë 25.06.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2024-624, datë 30.01.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka dërguar për gjykim procedimin penal nr.1/2016, në ngarkim të të pandehurve Denis Shtraza (*kërkuesi*) dhe shtetasit E.D., të akuzuar për veprat penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit, paraprirë ose shoqëruar me tortura fizike dhe kur është shkaktuar vdekja e tij”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 109, paragrafi 3-25 të Kodit Penal (*KP*) dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 5 i *KP*-së. I pandehuri E.D., në datën 25.04.2017, gjatë gjykimit të çështjes (në fazën fillestare të tij) ka ndërruar jetë dhe gjykimi i çështjes penale ka vijuar ndaj kërkuesit.

2. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 31, datë 19.03.2018, ka vendosur: deklarin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, e paraprirë ose shoqëruar me tortura fizike dhe kur është shkaktuar vdekja e tij, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 109, paragrafi i tretë, dhe 25 të *KP*-së dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm; deklarin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i *KP*-së (sipas ndryshimit të bërë me ligjin nr. 82/2016, datë 25.07.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 21.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”” (*ligji nr. 82.2016*)) dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim. Bazuar në nenin 55 të *KP*-së është vendosur përfundimisht dënimi me burgim të përjetshëm, vuajtja e cilit ka filluar nga data 29.01.2016 (dita e ndalimit).

3. Kërkuesi ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, e cila, me vendimin nr. 61, datë 25.06.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 31, datë 19.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

4. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-624, datë 30.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

5. Kërkuesi në datën 13.05.2024 nëpërmjet shërbimit postar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

6.1. *E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi çështja nuk është gjykuar nga gjykata kompetente. Për veprat penale, për të cilat kërkuesi është gjykuar nga Gjykata për Krime të Rënda, duhej të gjykohej nga Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Durrës. Bazuar në nenin 75/a të KPP-së, pas ndryshimeve të vitit 2017, ku përcaktohen kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, funksion të cilin e ka ushtruar Gjykata për Krime të Rënda, nuk përfshihet asnjë nga veprat penale. Pretendimi është ngritur në çdo shkallë të gjykimit, por gjykatat nuk e kanë shqyrtuar, megjithëse ishin të detyruara të shpreheshin për kompetencën e tyre lëndore.

6.2. *E drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në rekurs janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, si për gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe Gjykata e Lartë duhet të mbante qëndrim. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit, pasi nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i paqartë, jologjik, kontradiktor dhe i parregullt në formë e në përmbajtje, si dhe nisur nga fjalori i përdorur nuk kuptohet qëndrimi i saj. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është munduar të arsyetojë duke përdorur fjalë që nuk ekzistojnë në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, duke e bërë të pakuptueshëm vendimin.

6.3. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi ai është dënuar pa prova, vetëm mbi bazën e dyshimeve, të cilat duhet të shkonin në favor të tij dhe barra e provës i takon palës akuzuese. Në arrestimin e tij nuk është gjendur asnjë send i paligjshëm (armë ose çfarëdo sendi tjetër), por ai është dënuar për armëmbajtje pa leje. Makina në të cilën janë gjetur provat që i janë nënshtruar vlerësimit të ekspertëve, nuk është makina e kërkuesit, por e të bashkëpandehurit tjetër, i cili ka ndërruar jetë gjatë gjykimit. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka arsyetuar se nga procesverbalet e këqyrjes ose ekspertimet teknike të telefonave dhe kartave *sim*, nuk është evidentuar ndonjë e dhënë që të lidhë kërkuesin me faktin penal ose me personat që i kanë përdorur realisht ato, por në vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, rrethana të tilla nuk e përjashtojnë *apriori* pjesëmarrjen e kërkuesit në veprimet ndaj viktimës. Cenimi i këtij parimi bëhet më evident kur gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se fakti që gjurmët e gjakut të gjetura në automjet nuk janë të kërkuesit, nuk ka vlerë provuese në gjykim, për sa kohë që prania fizike e tij në automjet është vërtetuar drejtpërdrejt në momentin kapjes nga policia. Vepra penale e rrëmbimit është kryer me një automjet tjetër dhe jo me atë që është kapur kërkuesi. Bazuar në vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit në asnjë moment nuk është vërtetuar se kërkuesi ka kryer veprën penale. Referuar dëshmive të dhëna gjatë gjykimit ka rezultuar se kërkuesi

nuk ndodhej në zonën ku ka ndodhur ngjarja, por përsëri gjykatat nuk i kanë marrë parasysh ato, duke e dënuar kërkuesin mbi bazën e dyshimeve. Pretendimet janë parashtruar në rekurs, por Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mosriparuar shkeljet e gjykatave më të ulëta.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse objekt i ankimit kushtetues individual është procesi gjyqësor, në përfundim të të cilit ai është dënuar penalisht për disa akuza, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike nënkupton jo vetëm që kërkuesi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t’i drejtohet Gjykatës, por edhe që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngrenë në këtë Gjykatë, t’i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka

shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Kolegji konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 13.05.2024, ndërsa vendimi gjyqësor më i fundit që kundërshtohet prej tij është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 30.01.2024. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur në datën 13.05.2024 është brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuesit lidhen me cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të prezumimit të pafajësisë.

13. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, Kolegji vëren se kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është dënuar pa prova dhe vetëm mbi bazën e dyshimeve, të cilat duhet të shkonin në favor të tij dhe jo të interpretoheshin nga gjykatat sikur ai kishte kryer veprat penale. Nga prokuroria nuk është evidentuar asnjë e dhënë që të lidhte kërkuesin me faktin penal. Gjykatat kanë vlerësuar në mënyrë të gabuar gjurmët e gjakut të gjetura në automjetin që kishte shërbyer për të kryer veprat penale, duke u shprehur se ato nuk kishin vlerë provuese, për sa kohë që prania e kërkuesit ishte vërtetuar drejtpërdrejt nga policia në momentin e ndalimit. Kërkuesi ka vijuar duke parashtruar se automjeti ka qenë e të bashkëpandehurit tjetër, i cili ka ndërruar jetë.

14. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Gjykatat janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t’i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjithashtu, Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit çmuarja e provave, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, si dhe të çmuarjes së provave për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 45, datë 23.07.2012; nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në këndvështrim të standardeve kushtetuese, Kolegji vëren se argumentet e kërkesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë kanë të bëjnë me vlerësimin e provave nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, pra me themelin e çështjes në raport me rrethanat e çështjes konkrete dhe, si të tilla, nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Pretendimet për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligji, së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, që janë garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës dhe do të analizohen në vijim nga Kolegji.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

18. Kërkuesi ka pretenduar se është gjykuar nga Gjykata për Krime të Rënda, ndërkohë duhej të gjykohej nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Sipas kërkesit, pretendimi është ngritur në çdo shkallë të gjykimit, por gjykatat nuk e kanë shqyrtuar, megjithëse ishin të detyruara të shpreheshin për kompetencën e tyre lëndore.

19. Gjykata ka theksuar se termi “*gjykatë*” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit. Kompetenca e gjyqtarit është kufiri që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar. Në këtë kontekst, fjala “ligj”, sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën

e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme (*shih vendimet nr. 27, datë 09.05.2012; nr.23, datë 23.07.2009; nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është “e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 62, datë 04.11.2016; nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Kolegji vëren se çështja penale në ngarkim të kërkuesit është regjistruar në datën 12.12.2016 në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe sipas nenit 75/a të KPP-së, referuar kohës kur është regjistruar, në kompetencën e kësaj gjykate përfshihej edhe gjykimi i veprave penale të parashikuara nga nenet 109 dhe 278 të KP-së, për të cilat është akuzuar dhe gjykuar kërkuesi.

22. Në vijim, pas ndryshimeve në KPP me ligjin nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 35/2017*), referuar dispozitës kalimtare të tij dhe vendimit njëses nr. 13/2018 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, u përcaktua se çështjet e paraqitura në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda përpara datës 01.08.2017 (data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 35/2017) do të vazhdonin të gjykoreshin në këtë gjykatë edhe pas kësaj date, deri në momentin e krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

23. Në vijim të analizës ligjore dhe fakteve, Kolegji vëren se çështja e kërkuesit është regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në datën 12.12.2016 dhe gjykimi në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda ka përfunduar në datën 25.06.2018, pra çështja ka qenë e regjistruar përpara datës 01.08.2017 të hyrjes në fuqi të ndryshimeve në nenin 75/a të KPP-së. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se, referuar dispozitave ligjore, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka pasur kompetencë për gjykimin e veprave penale, për të cilat është gjykuar dhe dënuar kërkuesi, ndaj shqyrtimi i çështjes prej saj nuk ka cenuar standardin kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj. Për argumentin e kërkuesit se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje këtij pretendimi, Kolegji konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në parimin e vazhdimësisë së gjykimit, ka vlerësuar si kompetente Gjykatën për Krime të Rënda (*shih paragrafin 74 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

24. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

25. Kërkuesi ka pretenduar se në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese për gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimin e prezumimit të pafajësisë, për të cilat Gjykata e Lartë duhej të mbante qëndrim. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i paqartë, jologjik, kontradiktor dhe i parregullt në formë e në përmbajtje. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është munduar të arsyetojë, por duke përdorur fjalë që nuk ekzistojnë në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, duke e bërë të pakuptueshëm vendimin.

26. E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprat penale: (i) “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, i paraprirë ose shoqëruar me tortura fizike, kur është shkaktuar vdekja e tij, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 109, paragrafi i tretë, dhe 25 të KP-së dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm; (ii) “Mbajtja pa leje e armëve”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së (sipas ndryshimit të bërë me ligjin nr. 82/2016) dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, bazuar në nenin 55 të KP-së, ka vendosur përfundimisht dënimin me burgim të përjetshëm.

30. Në mënyrë të përmbledhur, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në dhënien e vendimit u është referuar dëshmive të disa personave, deklarinimeve të kërkuesit të marra gjatë hetimeve paraprake dhe provave të administruara (profileve gjenetike të përftuara nga gjaku; procesverbalit të këqyrjes së kufomës; ekspertimit mjekoligjor; ekspertimeve teknike balistike të gëzhgojave dhe predhave; ndalimit të i kërkuesit në automjetin e përdorur për marrjen me forcë të viktimës). Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda i ka dhënë përgjigje pretendimit lidhur me telefonat e sekuestruar dhe gjurmët e gjakut të gjetura në automjet. Sipas Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda fakti se asnjë nga telefonat nuk i përket kërkuesit dhe se gjurmët e gjakut nuk janë të tij, janë rrethana që nuk e përjashtojnë *apriori* kërkuesin nga pjesëmarrja në veprimet e kryera ndaj viktimës, për sa kohë prania fizike e tij është vërtetuar drejtpërdrejt, pasi është kapur nga policia menjëherë pas kryerjes së veprës penale (*shih faqet 25-26 të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda*). Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (*shih faqet 22-25 të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda*).

31. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vlerësuar se, referuar arsytimit të gjykatave dhe shkaqeve të rekursit të kërkuesit në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave dhe se vendimi i ankimuar nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, rekursi nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432, pika 1, të KPP-së, duke vendosur në përfundim mospranimin e tij.

32. Kolegji vlerëson se bazuar në standardet kushtetuese dhe referuar në tërësi përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i përmbush elementet e

vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Ai ka respektuar elementet formale, duke pasqyruar të dhënat e palëve në procesin gjyqësor penal, shkaqet e parashtruara në ankim dhe rekurs, vendimet e gjykatave më të ulëta, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ka mbështetur qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Vendimi nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e tij. Kolegji vlerëson se duke pasur parasysh natyrën e vendimit të mospranimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të marrë në dhomën e këshillimit gjatë procedurës së seleksionimit, mënyra e arsytimit të tij, bazuar në standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, qoftë edhe e kufizuar, nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Për më tepër që, në rastin konkret, ky kolegji u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit të parashtruara në rekurs në lidhje me gjykatën kompetente për gjykimin e çështjes së tij (sikurse është analizuar edhe më sipër), si dhe pretendimeve e tjera për vlerësimin dhe papërdorshmërinë e akteve e të provave të marra nga prokuroria. Për pretendimin se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i pakuptueshëm, për shkak të përdorimit të termave teknike, kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë argument për të konkretizuar ardhjen e pasojave në të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor, për më tepër që në Gjykatën e Lartë, në përputhje me parashikimet ligjore, kërkuesi ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtësi i tij.

33. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

34. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.